



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr. 322/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit L.E. nga fshati S., komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë P.nr.466/2018 të datës 21.11.2019 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1587/2019 të datës 29.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.12.2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit L.E., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë P.nr.466/2018 të datës 21.11.2019 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1587/2019 të datës 29.09.2020.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë P.nr.466/2018 të datës 21.11.2019, i dënuari L.E. është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK, për të cilën është gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 4.000 (katërmijë) € e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € do ti llogaritet me një ditë burgimi. I dënuari është obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit

gjqësor në shumën prej 100 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 €.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1587/2019 të datës 29.09.2020, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit L.E., kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit N.H., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë këtë kërkesë si të bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.177/2020 e datës 24.11.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

Kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se i dënuari L.E. edhe pse në shqyrtimin gjyqësor e kishte pranuar fajësinë, përmes një shkrese me datën 01.11.2019 i është drejtuar gjykatës dhe i ka bërë me dije se i dënuari nuk dinte fare për pasojat e pranimi të fajësisë gjegjësisht nuk kishte pasur konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij sa i përket kësaj rrethane.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e mbrojtësit të dënuarit nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përfshi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as shkelje të ligjit penal. Siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor i datës 30.10.2019, i dënuari L.E. e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë sipas aktakuzës. Nga ky procesverbal i shqyrtimit gjyqësor rezulton se i dënuari ka qenë i njoftuar nga gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 323 par.1 të KPPK-së, për të gjitha të drejtat e tij. I dënuari pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare, pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e një pranimi të tillë. Prandaj, pretendimet e mbrojtësit se i dënuari nuk dinte fare për pasojat e pranimi të fajësisë gjegjësisht nuk kishte pasur konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij sa i përket kësaj rrethane, janë të pabazuara, sepse këto pretendime nuk kanë mbështetje në asnjë provë e as në shkresat e lëndës. Po ashtu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet se mbrojtësi i të dënuarit ta ketë kundërshtuar

pranimin e fajësisë nga i dënuari por rezulton se edhe mbrojtësi është pajtuar me pranimin e fajësisë të bërë nga i dënuari. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkangjitura të aktakuzës. Gjykata e shkallës së parë duke gjetur se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, ka aprovuar pranimin e fajësisë së bërë nga i dënuari dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në pjesën tjetër të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i referohet vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se KEDS gabimisht kishte konstatuar se L.E. e kishte keqpërdorur energjinë elektrike dhe i kishte faturuar shumën prej 23.218.75 €. pa asnjë bazë ligjore.

Lidhur me pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit të dënuarit ku bëhet fjalë për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë nuk është lëshuar në vlerësimin e kësaj shkelje, për faktin se në nenin 432 par.2 të KPPK, është përcaktuar se “ kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike”, andaj kërkesa e ushtruar për këtë bazë, është e palejuar.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.322/2020, më datë 08.12.2020

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj